

Gzim Rushiti, MA¹

UDC: 327(4-672EY)

355.02(4-672EY)

**POLITIKA E PËRBASHKËT E JASHTME E BASHKIMIT
EVROPIAN**

**ЗАЕДНИЧКА НАДВОРЕШНА ПОЛИТИКА НА
ЕВРОПСКАТА УНИЈА**

COMMON FOREIGN POLICY OF THE EUROPEAN UNION

Abstract

Through common foreign policy the European Union develops relations with other international entities and extends its influence on the world. Common foreign and security policy has two parts: Common foreign foreign policy and European security and defense policy. CFSP it is a continuation of European political cooperation which in the 1970s appeared as intergovernmental cooperation outside the EC institutions, as a diplomatic process parallel to the EC but not part of it. Following the entry into force of the Lisbon Treaty, the leadership of the CFSP is unified and centralized in the permanent President of the European Council and in the High Representative for the CFSP. CFSP realized through specific instruments such as: common strategies, joint attitudes, joint action and statements. Decisions in the CFSP deal with unanimity but the Council can also use the qualified majority. The European project offers the basis for the continent's security dimension. The Lisbon Treaty also envisages the development of a common defense and security policy as an integral part of CFSP of the European Union. The EU has a number of strategic goals in foreign policy. The EU is developing

¹ Autori është student në studimet e Ciklit të tretë në Fakultetin Juridik në Manastir në Universitetin "Shën Klimenti i Ohrit", drejtimi E drejta ndërkombëtare dhe politika ndërkombëtare, e-mail adresa: ge-zim1990@hotmail.com

as the only institution that has a whole spectrum of civil and military opportunities for intervention during the crisis. Being so on the road to the creation of a more operative CFSP, The European Union will have more opportunities to contribute to international stability and security.

Keywords: *EU's external common policy, EU defense and security policy, Institutions, procedures and decisions for the realization of common foreign and security policy, Perspectives and strategic goals of common foreign and security policy.*

Një nga politikat e rëndësishme të Bashkimit Evropian, përmes së cilës ajo zhvillon marrëdhëniet me subjektet tjera ndërkombëtare dhe shtrinë ndikimin e vet në botë është politika e jashtme e BE-së. Ajo është një politikë ndërqeveritare e Bashkimit Evropian dhe jokomunitare, çfarë kryesisht ishin politikat nga shtylla e parë. Karakteri ndërqeveritar i politikës së jashtme të BE-së buron nga sensitiviteti i çështjeve që përfshihen brenda saj dhe atë kryesisht nga interesat e shteteve anëtare të BE-së, për çka autorë të ndryshëm e kualifikojnë si diçka “midis retorikës dhe realitetit”. Prandaj vendimmarrja në politikën e jashtme të Bashkimit Evropian edhe më tutje mbetet konsensuale.² Kompetenca e Bashkimit në çështjet e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit i mbulon të gjitha fushat e politikës së jashtme dhe të gjitha çështjet e lidhura me sigurinë e Bashkimit, duke përfshirë krijimin progresiv të një politike të përbashkët për mbrojtjen, e cila mund të çojë në një mbrojtje të përbashkët. Shtetet anëtare e mbështesin aktivisht dhe pa rezerva politikën e jashtme dhe të sigurimit të Bashkimit, me frymën e besnikërisë dhe solidaritetit të ndërsjellë dhe e respektojnë veprimin e Bashkimit në këtë fushë. Shtetet anëtare punojnë së bashku për ta rritur dhe zhvilluar solidaritetin e tyre të ndërsjellë politik. Ato nuk kryejnë asnjë veprim që bie ndesh me interesat e Bashkimit ose që ka të ngjarë ta ulë efektivitetin e tij si një forcë kohezive në marrëdhëniet ndërkombëtare. Këshilli dhe Përfaqësuesi i Lartë sigurojnë respektimin e këtyre parimeve.³ PPJS ka dy pjesë:

² Blerim Reka, Otmar Höll, Ylber Sela, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian, Arbëria Design, Tetovë, 2010, f. 118.

³ Version i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të drejtave themelore e Bashkimit Evropian, Botuar nga Ministria e Integritimit, Tiranë, Shqipëri, Neni, 24

1. Politika e Jashtme e Përbashkët (shprehja e qëndrimit të BE-së në arenën ndërkombëtare).

2. Është Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes, e përcaktuar në nenin 17 të BE-së.⁴

Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë rregullohet në Titullin V të TBE i cili mbulon gjithashtu marrëdhëniet me jashtë (ish Titulli V të Traktatit të Bashkimit Evropian). Kjo politikë zëvendësoi Bashkëpunimin Politik Evropian dhe parashikoi kuadrin aktual të një politike të përbashkët mbrojtjeje, e cila në kohën e duhur do të çonte në një mbrojtje të përbashkët.⁵

Qëllimet e shtyllës së dytë të Bashkimit Evropian janë përcaktuar në Nenin 11 të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe do të arrihen përmes instrumenteve specifike ligjore të cilat duhet të miratohen nga Këshilli me unanimitet.⁶ Hazel Smit, në librin e tij *European Foreign Policy: What it Is and What it Does*, konstaton se BE-ja ka një politikë të jashtme dhe se mund të analizohet në një mënyrë të ngjashme me atë të cilitdo shtet. Sipas tij, me politikë të jashtme nënkuptojmë kapacitetet për të marrë dhe për të zbatuar vendime të jashtme, të cilat i promovojnë vlerat vendore, interesat e jashtme dhe politikën e aktorit në fjalë.⁷

Politika e përbashkët me jashtë dhe e sigurisë paraqet shtyllën e dytë të Unionit, përmes së cilës shtetet anëtare paraqesin qëndrimet e tyre të përbashkëta për çështjet që kanë të bëjnë me zgjidhjen e konflikteve të armatosura, të drejtave të njeriut e disa çështje të tjera, në pajtim me vlerat dhe parimet themelore të Bashkimit Evropian.⁸ PPJS-ja konsolidohet nga parimet e veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian dhe udhëhiqet nga një parim kryesor i saj që është koherenca.⁹

⁴ Abdulla Azizi, *Bashkimi Evropian – E drejta, institucionet dhe politikat*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, f. 332.

⁵ Fjalorth për Integrimin Evropian, *Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian*, Botim i Ministrisë së Integritimit, Tiranë, Prill, 2010, f. 112.

⁶ Glosar për integrimin Evropian, *Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian*, Botim i Ministrisë së Integritimit Evropian, Tiranë, f. 91.

⁷ Sylë Ukshini, *Kosova në politikën e jashtme të BE-së 1991-2007*, Logos-A, Shkup, 2008, f. 53.

⁸ Shpresa Shehu-Kursani, *Shtegtimi i Bashkimit Evropian*, Universiteti Iliria, Prishtinë, 2006, f. 120.

⁹ Jonida Mehmetaj, *Roli i Bashkimit Evropian për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare në kuadër të politikës së jashtme dhe të sigurisë së përbashkët*, punim doktore, Tiranë, Mars, 2016, f. 245.

Evaluimi historik i politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë

Në takimin e Hagës, në vitin 1969, liderët e BE-së bënë thirrje që vendet anëtare të bashkëpunonin në politikën e jashtme nën një procedurë të njohur si Bashkëpunim Politik Evropian.¹⁰ Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë (PPJS) është vazhdimësi e “Bashkëpunimit Politik Evropian” i cili në vitet e 70 u paraqit si bashkëpunim ndërqeveritar jashtë institucioneve të KE-së, si një proces diplomatik paralel me KE-të, por jo edhe pjesë e tij. Objektivi kryesor i EPC-së ishte në fakt konsultimi dhe koordinimi i politikave të jashtme të vendeve anëtare, por jo zhvillimi i një politike të jashtme të përbashkët të Komunitetit.¹¹ Në traktatet themeluese të KE-ve politika e jashtme kishte mbetur në kompetencë të shteteve anëtare, ndërsa realizimi i bashkëpunimit në politikën e jashtme realizohej në bazë të konsensusit politik, pa pasur bazë juridike dhe mbështetje për veprim në këtë fushë. Komunitetet Evropiane nuk kanë pasur bazë legjislative për të vepruar në fushën e politikës së jashtme deri në vitin 1991, kur me Traktatin e Mاستrihtit (titulli V) u krijua baza juridike dhe korniza organizative për PPJS-në.¹² Traktati i Mاستrihtit, me orientimin strategjik që UE, pos si fuqi ekonomike, të bëhet edhe me identitetin e vet politik dhe të mbrojtjes, inauguroi edhe dy shtylla të reja: atë të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë dhe atë mbi drejtësinë dhe punët e brendshme.¹³

Në qendër të Marrëveshjes së Mاستrihtit dhe të Marrëveshjes së Amsterdami, që janë theksuar në debatin e reformave, qëndronte përgjegjësia e zgjuar e GASP-it, struktura më efiçente për vendime dhe transparenca më e mirë në paraqitjen e jashtme të 15-shës.¹⁴ Dispozita mbi politikën e jashtme dhe të sigurisë së përbashkët - PJSP (titulli V), përfaqëson një nga risitë më të rëndësishme të Traktatit të Mاستriht-it dhe është rezultati përfundimtar i negociatave të gjata në konferencën ndërqeveritare të thirrur në vitin 1990. E trajtuar edhe në Aktin Unik

¹⁰ Desmond Dinan, *Politikat e Bashkimit Evropian*, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë, f. 299.

¹¹ Abdulla Azizi, *Bashkimi Evropian - E drejta, institucionet dhe politikat*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, f. 327.

¹² Abdulla Azizi, *Bashkimi Evropian - E drejta, institucionet dhe politikat*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, f. 328.

¹³ Blerim Reka, Arta Ibrahim, *Studime Evropiane*, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, f. 69.

¹⁴ Werner Wajdenfeld, Wolfgang Wessels, *Evropa prej A deri në ZH*, Doracak i integritimit evropian. Botimi i dytë i licencuar në gjuhën shqipe, Fondacioni-Konrad-Adenauer, Prishtinë, 2005, f. 257.

Evropian kjo çështje mori një përmbajtje më të gjerë dhe më të përcaktuar. Në Traktat përcaktohej se, përveç objektivave për ruajtjen e vlerave të përbashkëta, interesave dhe ruajtjes së paqes dhe sigurimit kombëtar, zhvillimit të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, PJSP-ja do të merrej dhe me forcimin e sigurimit të Bashkimit Evropian dhe të shteteve anëtare me të gjitha format. Këto objektiva do të arriheshin nëpërmjet bashkëpunimit. Risitë sistematike midis vendeve anëtare për çështje të politikës së jashtme dhe të sigurisë si dhe nëpërmjet aksioneve të përbashkëta që do të realizoheshin në fushat ku shtetet anëtare kanë interesa të përbashkëta të rëndësishme. Traktati e zgjeroi PJSP-në edhe në atë të mbrojtjes së përbashkët.¹⁵

Risitë e Traktatit të Amsterdimit në fushën e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë kishin të bënin, së pari, me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, e cila, sipas Traktatit të Amsterdimit, bazohet në parimin e integritetit territorial dhe konform parimeve të Kartës së OKB-së, me thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë të shteteve anëtare dhe zhvillimin e formave të reja të solidaritetit politik reciprok dhe me gatishmërinë e Unionit që t'u përgjigjet detyrimeve humanitare dhe paqeruajtëse. Traktati i Amsterdimit sjell risi edhe në procesin e vendimmarrjes. Traktati përcakton që BE-ja të përfaqësohet në politikën e jashtme, ndryshe nga periudha e kaluar, nga Kryesia e Këshillit, Komisioni Evropian, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, i cili do të veprojë si përfaqësues i lartë i BE-së për politikë të përbashkët të jashtme dhe sigurisë.¹⁶ Ndërsa, në Samitin e shefave të shteteve dhe të qeverive të BE-së, të mbajtur në Nicë, në vitin 2000, që kryesisht u mor me aftësitë e zgjerimit të BE-së, rezultatet në fushën e PPJS-së u kufizuan në zgjerimin e vendimeve të shumicës në Këshill, si dhe të mundësisë së përdorimit të bashkëpunimit të sforcuar. Rezultatet e këtij samiti, megjithëse u kontestuan, shënuan një hap të rëndësishëm të integritetit të politikës evropiane të sigurisë dhe të mbrojtjes. Krahas krijimit të Komitetit Politik dhe të Sigurisë, u nënvizua pasusi i BPE-së në nenin 17 të TBE-së, sipas të cilit u sanksionua se shumë detyra të BPE-së përfundimisht kalonin te BE-ja. Që t'i shmangej problemit gjatë procesit të ratifikimit nga shtetet anëtare, Këshilli i Evropës e bëri jashtë traktatit ndërtimin e shpejtë të infrastrukturës së mbrojtjes evropiane.¹⁷

¹⁵ Erjona Canaj, Sokol Bana, E drejta e Bashkimit Evropian, Onufri, Tiranë, 2014, f. 40.

¹⁶ Blerim Reka, Ylber Sela, Hyrje në të drejtën e Bashkimit Evropian - e drejta kushtetuese dhe e drejta institucionale e BE-së, Arbëria Design, Tetovë, 2011, f. 91.

¹⁷ Sylë Ukshini, Kosova në politikën e jashtme të BE-së 1991-2007, Logos-A, Shkup, 2008, f. 57.

Me Traktatin e Lisbonës bëhen përpjekje institucionale-politike për:

- ❖ Integrimin e kapaciteteve të politikës së jashtme evropiane;
- ❖ Prezantimi i institucionit “President i Këshillit Evropian”;
- ❖ Prezantimi i institucionit “Përfaqësues i Lartë i Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë” dhe prezantimi i “Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm”;

- ❖ Konstituimi i një entiteti të vetëm juridik të BE-së dhe;
- ❖ Progresi në fushën e politikës evropiane të sigurisë dhe mbrojtjes.

Duke integruar kapacitetin e politikës së jashtme të BE-së dhe duke bashkuar tre shtyllat e saj institucionet racionalizohen në drejtim të ofrimit të një mekanizmi efikas dhe të thjeshtuar, të përshtatshme për efektin e një politike të jashtme koherente. Përveç kësaj, po bëhen përpjekje për legjitimimin e Bashkimit si një subjekt politik autonom, me identitetin e vet të politikës së jashtme.¹⁸

Roli i institucioneve në përcaktimin e PPJS-së

Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, udhëheqja e kësaj politike të jashtme të Bashkimit Evropian unifikohet dhe centralizohet në Presidentin e Përhershëm të Këshillit Evropian dhe në Përfaqësuesen e Lartë për PPJS, e cila njëkohësisht është edhe nënkryetare e KE.¹⁹

Presidenca e Këshillit të Bashkimit Evropian organizohet në bazë të një sistemi rotacioni gjashtëmujor, ku secili shtet anëtar mban cilësinë e Presidencës për një periudhë gjashtëmujore. Rendi i rotacionit vendoset nga Këshilli i Bashkimit Evropian, me unanimitet. Mbajtja e Presidencës është detyra e secilit shtet anëtar, si edhe një kontribut në drejtim të funksionimit normal të institucioneve të Komunitetit. Përgjegjësitë e Presidencës janë:

- Kryesimi i mbledhjeve të Coreper dhe të grupeve të punës dhe komiteteve të tjera të Këshillit;
- Përfaqësimi i Bashkimit në lidhje me PPJS (mbi ndihmën e Përfaqësuesit të Lartë për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë).

Sipas Traktatit të Lisbonës, Këshilli i Punëve të Jashtme kryesohet nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Sigurinë. Bashkëpunimi me grupe nga tre i presidencave gjashtëmujore të

¹⁸ Goran Iliq, *Evropa në udhëkryq*, Manastir, 2009, f. 99.

¹⁹ Blerim Reka, Otmar Höll, Ylber Sela, *Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, f. 119.

njëpasnjëshme është rikonfirmuar nga Traktati i Lisbonës, me qëllim inkurajimin, vazhdimin dhe planifikimin strategjik në të gjithë presidencat gjashtëmujore.²⁰

Me Traktatin e Amsterdimit u krijua një post i ri i përfaqësuesit të lartë të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë. Ky post mbahet nga sekretari i përgjithshëm i Këshillit, detyra e të cilit është të ndihmojë presidencën e Bashkimit në çështjet që lidhen me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë. Ai/Ajo që mban këtë post njihet edhe si “Z/ZNJ CFSP” (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë). Përfaqësuesi i lartë i lejon Bashkimit Evropian të shprehet me koherencë dhe transparencë në skenën ndërkombëtare duke i dhënë atij një fytyrë dhe zë të dallueshëm. Përfaqësuesi i lartë ndihmon edhe në formulimin, përgatitjen dhe zbatimin e vendimeve të politikës nga Këshilli. Ai ose ajo mund të krijojnë dialog politik me palë të treta në emër të Këshillit me kërkesën e Presidencës.²¹

Instrumentet për realizim e PPJS-së

PPJS-ja realizohet përmes instrumenteve specifike, të ndryshme nga instrumentet e politikave të shtyllës së parë:

- Strategjitë e përbashkëta, vendosen nga Këshilli Evropian me rekomandim të Këshillit, në fushat ku shtetet anëtare kanë interesa të posaçme.²²

- Qëndrimet e përbashkëta përcaktojnë qasjen e Bashkimit ndaj një çështjeje të caktuar në përputhje me (Nenet 15 dhe 34 (2) (a) të Traktatit të BE-së). Lidhur me PPJS-në thuhet se çështja përkatëse është e natyrës gjeografike apo tematike dhe në lidhje me çështje të tilla, traktati i BE-së, kërkon që shtetet anëtare të veprojnë në organizatat ndërkombëtare ose konventat ndërkombëtare, për të siguruar që politikat e tyre kombëtare përafrohet me qëndrimet e përbashkëta.²³

- Veprimi i përbashkët, është një instrument ligjor në përputhje me Titullin 5 të Traktatit për Bashkimin Evropian (Politika e Përbashkët

²⁰ Fjalorth për Integrimin Evropian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian, Ministria e Integritimit, Tiranë, Prill, 2010, f. 118.

²¹ Glosar për integrimin Evropian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian, Botim i Ministrisë së Integritimit Evropian, Tiranë, f. 88.

²² Abdulla Azizi, Bashkimi Evropian - E drejta, institucionet dhe politikat, Arbëria Design, Tetovë, 2010, f. 333.

²³ Ljupço Sotiroski, Hyrje në të drejtën e Bashkimit Evropian, Universiteti Goce Delçev - Shtip, Shtip, 2011, f. 90.

e Jashtme dhe e Sigurisë, CFSP), nënkupton veprimin e koordinuar të shteteve anëtare, me të gjitha llojet e burimeve (burimet njerëzore, njohuritë, financimet, pajisje, etj.) mobilizohen për të arritur një qëllim specifik të vendosur nga Këshilli, bazuar në udhëzimet e përgjithshme të Këshillit Evropian.²⁴

- Deklaratat, me të cilat shpallen publikisht pikëpamjet e BE-së mbi incidentet e ndodhura në çdo pjesë të botës.²⁵

Vendimmarrja në kuadër të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë

Si zakonisht, forma me të cilën miratohen këto instrumente, përkatësisht vendimet në PPJS, bëhen me:

1. Unanimitet, mirëpo shtetet anëtare kanë mundësi të përdorin abstenim konstruktiv, në bazë të nenit 23 të Traktatit të Amsterdimit.

2. Këshilli mund të përdor shumicën e kualifikuar në rast të miratimit të vendimit për zbatimin e strategjisë së përbashkët ose një qëndrimi të përbashkët paraprakisht të vendosur nga Këshilli. D.m.th, të vetmet përjashtime nga rregulli i unanimitetit që traktati parashikon, janë vendimet për zbatimin e një veprimi të përbashkët që mund të merren me shumicë votash.²⁶

Politika e përbashkët e mbrojtjes dhe e sigurisë e Bashkimit Evropian

Projekti evropian ofron bazën për dimensionin e sigurisë së kontinentit. Për më tepër, përparime të mëdha janë bërë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes që nga fillimi i ESDP-së, inicuar pas një takimi të vitit 1998 në Saint-Malo midis Presidentit Shirak dhe Kryeministrit Blair. Strategjia Evropiane e Sigurisë u miratua zyrtarisht nga Këshilli i BE-së në dhjetor 2003. Në këtë dokument historik, BE-ja krijoi një kurth të politikës së jashtme të bazuar në multilateralizmin dhe angazhimin

²⁴ Tanja Karakamisheva, Veronika Efremova, Udhëzues për terminologjinë e Bashkimit Evropian, Shkup, 2009, f. 328.

²⁵ Abdulla Azizi, Bashkimi Evropian - E drejta, institucionet dhe politikat, Arbëria Design, Tetovë, 2010, f. 334.

²⁶ Abdulla Azizi, Bashkimi Evropian - E drejta, institucionet dhe politikat, Arbëria Design, Tetovë, 2010, f. 335.

parandalues, në mënyrë që të kontribuojë në stabilitetin dhe prosperitetin e fqinjëve të saj.²⁷

Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët është kategorizuar, si një nga komponentët më të rëndësishëm, dhe pjesë integrale e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët. Qëllimi i Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët konsiston në forcimin e aftësive të veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian, nëpërmjet zhvillimit të aftësive civile dhe ushtarake, për parandalimin e konflikteve dhe menaxhimin e krizave ndërkombëtare. Nëpërmjet kësaj politike Bashkimi Evropian ndërhyt drejtpërdrejt në konflikt, duke përcaktuar këtu rolin e tij si një aktor global dhe jo rolin e shteteve anëtare. PSMP-ja përfaqëson operacionet e armatosura të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.²⁸

Në përputhje me Traktatin e Lisbonës, parashikohet zhvillimi i një politike të përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes, si pjesë integrale e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së. Përmes një angazhimi të tillë, Bashkimit do t'i duhet t'i sigurohet "kapacitet operacional në përgatitjen e aseteve civile dhe ushtarake".²⁹ Konkretisht Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët trajton 5 lloje misionesh civile, aktivitetet për ruajtjen e paqes, parandalimin e konflikteve, menaxhimin e krizave, stabilitetin postkonflikt dhe misionet humanitare.³⁰

Prandaj, politika e përbashkët e sigurisë dhe e mbrojtjes do të përfshijë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e Bashkimit, duke përfshirë formimin e një politike të mbrojtjes, si një hap fillestar drejt formimit të një mbrojtjeje të përbashkët evropiane.³¹

Kompetencat e Unionit në lidhje me çështjet e PPJS -së, do të mbulojnë të gjitha fushat e politikës së jashtme dhe të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e Unionit, duke përfshirë kornizën progresive të një politike të përbashkët të mbrojtjes që mund të çojë në një mbrojtje të përbashkët.³²

²⁷ Nano Ruzhin, NATO në marrëdhëniet bashkëkohore ndërkombëtare, Shkup, 2010, f. 207.

²⁸ Jonida Mehmetaj, Roli i Bashkimit Evropian për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare në kuadër të politikës së jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, (punim doktore), Universiteti European i Tiranës, Tiranë, 2016, f. 173.

²⁹ Goran Iliq, Evropa në udhëkryq, Manastir, 2009, 115.

³⁰ Jonida Mehmetaj, Roli i Bashkimit Evropian për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare në kuadër të politikës së jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, (punim doktore), Universiteti European i Tiranës, Tiranë, 2016, f. 174.

³¹ Goran Iliq, Evropa në udhëkryq, Manastir, 2009, 116.

³² Christopher Hill, Michael Smith, Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe Bashkimi Evropian, Oxford University Press, 2011, f. 198.

Perspektivat dhe qëllimet strategjike të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë

BE-ja po zhvillohet si institucion i vetëm që posedon spektër të tërë të mundësive civile dhe ushtarake për intervenim gjatë krizave. Në këtë mënyrë është në rrugë për një politikë të jashtme dhe të sigurisë më operative dhe do të ketë më shumë mundësi për të projektuar stabilitet dhe t'i kontribuojë sigurisë ndërkombëtare.³³

PJSP dhe PESM kanë bërë një rrugë të gjatë në një kohë të shkurtër. Duke pasur parasysh hezitimin tradicional të vendeve anëtare për të bashkëpunuar në politikën e sigurisë dhe të mbrojtjes në kuadrin e integritimit evropian, procesi ka qenë mbresëlënës. Përsëri, duke marrë parasysh ndryshimet në potencialin ushtarak të vendeve anëtare, kapacitetet ushtarake të BE-së duken të pamjaftueshme. Gjithsesi, objektivi i PESM-së nuk ka qenë asnjëherë të krijojë një ushtri evropiane, por të vërë në dispozicion një forcë të BE-së në një shkallë relativisht të kufizuar për menaxhim krizash në pika të nxehta ndërkombëtare. Fuqia ushtarake e BE-së është modeste, por gjithnjë e më efektive. Opinione publike në Evropë zakonisht e mbështesin idenë e ndërhyrjeve ushtarake përtej kufijve të BE-së, nën kontrollin e OKB-së, për të luftuar raste të pastra agresioni. Megjithatë, të njëjtat opinione publike nuk janë entuziastë, shpenzojnë më shumë para për mbrojtjen. Komanda dhe kontrolli, shërbimet informative, transporti strategjik, trajnimi, logjistika dhe armët janë parakushte jashtëzakonisht të kushtueshme të një ndërhyrje të suksesshme ushtarake. Vendet anëtare mund të kursenin shumë para duke i eliminuar mbivendosjen mes forcave ushtarake kombëtare. Nga ana tjetër, pikërisht sepse çdo vend ka forcat e veta ushtarake, kjo mbivendosje është e pashmangshme. E pashmangshme dhe e pamënjanueshme.³⁴ Nëse Evropa dëshiron të zhvillojë një politikë të jashtme të bazuar në pushtetin e fortë dhe të butë, ajo do të lidhet përfundimisht me procesin më të përgjithshëm të integritimit.

Institucionet demokratike evropiane në praktikë nuk mund të kundërshtojnë mundësinë e luftës pa legjitimitet të plotë demokratik,

³³ Werner Wajdenfeld, Wolfgang Wessels, *Evropa prej A deri në ZH*, Doracak i integritimit evropian, Botimi i dytë i licencuar në gjuhën shqipe, Fondacioni-Konrad-Adenauer, Prishtinë, 2005, f. 228.

³⁴ Desmond Dinan, *Politikat e Bashkimit Evropian*, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë, f. 327.

nëse BE do të ishte e paaftë për të luftuar konfliktet me intensitet të lartë nëse kontrolli nuk transferohej në një nivel kolektiv evropian.³⁵

Ndikimi i Bashkimit Evropian në marrëdhëniet ndërkombëtare është gjithnjë e më i madh. Me vite të tëra, Bashkimi Evropian ka forcuar bashkëpunimin me një numër të madh të organizatave ndërkombëtare. Procesi i integrimi dhe vendosja e valutës së përbashkët në një anë, si dhe zhvillimi i politikës së jashtme dhe të mbrojtjes së përbashkët nga ana tjetër i ofruan Bashkimit një pozitë politike dhe diplomatike të atillë, që iu përshtatën plotësisht ndikimit dhe forcës së saj tregtare. Bashkimi ka një varg të qëllimeve strategjike në politikën e jashtme. I pari ndër to është krijimi i një Evrope stabile, zëri i së cilës do të dëgjohet në tërë botën.. Si njëri ndër partnerët më të mëdhenj në tregtinë botërore, Bashkimi Evropian është i vendosur në përpjekjet e mëtejme që të sigurojë pozitën e saj konkurruese ndërkombëtare. Megjithatë politika e jashtme nuk ka të bëjë vetëm me çështjet e tregtisë, sigurisë dhe diplomacisë. Janë këtu edhe shumë çështje të tjera që dukshëm ndikojnë në jetën e qytetarëve të Evropës, si lufta kundër AIDS-it, varfërisë, migrimet, drogës, terrorizmit. Ndryshimet në sferën ekonomike dhe politike nxisin nevojën e adaptimit të vazhdueshëm të politikës së jashtme dhe prioritetëve të BE-së, që realizohen përmes thellimit të bashkëpunimit me partnerët e vet, duke inkuadruar në këto raporte edhe dimensionin politik, ekonomik dhe atë tregtar. Sot, Bashkimi Evropian përmes formave të ndryshme të partneritetit ndër-rajonal dhe marrëveshjeve për bashkëpunim, ka mbështetje të plotë nga shtetet e ndryshme të pesë kontinenteve.³⁶ Ajo ka një rrjet të tërë të institucioneve në mbarë botën, të cilat i ndihmojnë në formësimin dhe aplikimin e politikës së saj.³⁷

Në përfundim duhet thënë se për dallim nga politikat e BE-së nga shtylla e parë, të cilat janë të rrumbullakuara dhe funksionojnë kryesisht përmes metodës komunitare, Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë, mbetet ende politikë në zhvillim e sipër, e cila edhe për një kohë do të përpëlitet midis përplasjeve të interesave të shteteve anëtare. Ajo është dhe mbase do të mbetet politikë e karakterit ndërqeveritar, meqë edhe sipas Traktatit të Lisbonës, vendimmarrja për politikën e jashtme të BE-së mbetet konsensuale. Prandaj si në të kaluarën ashtu

³⁵ Christopher Hill, Michael Smith, Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe Bashkimi Evropian, Oxford University Press, 2011, f. 42.

³⁶ Shpresa Shehu-Kursani, Shtegtimi i Bashkimit Evropian, Universiteti Iliria, Prishtinë, 2006, f. 119.

³⁷ Shpresa Shehu-Kursani, Shtegtimi i Bashkimit Evropian, Universiteti Iliria, Prishtinë, 2006, f. 120.

edhe sot kjo politikë ishte dhe mbeti jounike. Kjo ngase, politikat e jashtme të shteteve anëtare, jo gjithnjë përputheshin me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian.³⁸

Conclusion

EU foreign policy is an intergovernmental policy through which the European Union puts it, it maintains and develops relations with other global actors and expands its influence in the world. The intergovernmental character of the CPA derives from the sensitivity of the issues involved within it. The competence of the European Union in matters of common foreign policy and security covers all areas of foreign policy and all issues related to the security of the Union. European Union's Common Foreign and Security Policy regulated by title V of the European Union Treaty which also covers the external relationship of the EU. The European Union's common foreign and security policy has a historical continuity that begins in the 1970s of the 20th century and continues to this day. After the ratification of the Treaty of Lisbon, the management of the Common Foreign Policy of the European Union is unified and centralized in the Permanent President of the European Council and in the High Representative for the Common Foreign and Security Policy, who is also the vice-president of the European Council.

The Common Foreign and Security Policy of the European Union is implemented through instruments such as: common strategies, common goals, common action and declarations. Decisions on bringing these instruments into the Common Foreign and Security Policy are taken unanimously, but the Council can use a qualified majority. The European project provides the basis for the continent's security dimension. The European Union is on the way to creating a more operational Common Foreign and Security Policy and will have more opportunities to project stability and produce peace in the world in the 21st century and thus contribute to the development of global security in general.

Recensentë:

Prof. Dr. Enver Abdullahi

Prof. Dr. Goran Iliq

³⁸ Blerim Reka, Otmar Höll, Ylber Sela, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian, Arbëria Design, Tetovë, 2010, 125.

Literatura:

- 1) Abdulla Azizi, Bashkimi Evropian - E drejta, institucionet dhe politikat, Arbëria Design, Tetovë, 2010
- 2) Blerim Reka, Arta Ibrahim, Studime Evropiane, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë
- 3) Blerim Reka, Otmar Höll, Ylber Sela, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian, Arbëria Design, Tetovë, 2010
- 4) Blerim Reka, Ylber Sela, Hyrje në të drejtën e Bashkimit Evropian - e drejta kushtetuese dhe e drejta institucionale e BE-së, Arbëria Design, Tetovë, 2011
- 5) Christopher Hill, Michael Smith, Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe Bashkimi Evropian, Oxford University Press, 2011
- 6) Desmond Dinan, Politikat e Bashkimit Evropian, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë
- 7) Erjona Canaj, Sokol Bana, E drejta e Bashkimit Evropian, Onufri, Tiranë, 2014
- 8) Nano Ruzhin, NATO në marrëdhëniet bashkëkohore ndërkombëtare, Shkup, 2010
- 9) Sylë Ukshini, Kosova në politikën e jashtme të BE-së 1991-2007, Logos-A, Shkup, 2008
- 10) Goran Iliq, Evropa në udhëkryq, Manastir, 2009
- 11) Shpresa Shehu-Kursani, Shtegtimi i Bashkimit Evropian, Universiteti Iliria, Prishtinë, 2006
- 12) Jonida Mehmetaj, Roli i Bashkimit Evropian për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare në kuadër të politikës së jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, (punim doktore), Universiteti Evropian i Tiranës, Tiranë, 2016
- 13) Ljupço Sotirovski, Hyrje në të drejtën e Bashkimit Evropian, Universiteti Goce Delçev - Shtip, Shtip, 2011
- 14) Tanja Karakamisheva, Veronika Efremova, Udhëzues për terminologjinë e Bashkimit Evropian, Shkup, 2009
- 15) Werner Wajdenfeld, Wolfgang Wessels, Evropa prej A deri në ZH, Doracak i integritit evropian, Botimi i dytë i licencuar në gjuhën shqipe, Fondacioni-Konrad-Adenauer, Prishtinë, 2005
- 16) Fjalorth për Integritimin Evropian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian, Botim i Ministrisë së Integritit, Tiranë, Prill, 2010

17) Glosar për integrimin Evropian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian, Botim i Ministrisë së Integritimit Evropian, Tiranë

18) Version i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të drejtave themelore e Bashkimit Evropian, Botuar nga Ministria e Integritimit, Tiranë, Shqipëri

19) Jonida Mehmetaj, Roli i Bashkimit Evropian për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare në kuadër të politikës së jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, punim doktrature, Tiranë, Mars, 2016